

ÖSD – Tetovë



ÖSD (Österreichisches Sprachdiplom Deutsch) është nisme e disa ministrive austriake, me një sistem të kontrolluar të provimit të gjuhës gjermane sipas kritereve të përpiluara nga shteti austriak. Ajo orientohet në direktiva ndërkombëtare (si p. sh. Këshilli Evropian), ofron certifikim të standardizuar të njohurive gjuhësore dhe bazohet në *Common European Framework of Reference for Languages* si dhe *Profile Deutsch*. Diploma e ÖSD përputhet edhe me standardet e vendeve të tjera gjermanofolëse, si Gjermania apo Zvicra dhe njihet ndërkombëtarisht.

Në Universitetin Shtetëror të Tetovës ofrohen provime nga këto nivele të ÖSD-së:

Niveli A1

Teston njohuritë fillestare të gjuhës gjermane në situata të përditshme dhe është konceptuar për personat e moshës mbi 14-vjeçare. Kryerja e këtij niveli ndër të tjera është i domosdoshëm për marrjen e lejes së qëndrimit në Austri dhe Gjermani.

Niveli A2

Në nivel fillestar teston aftësitë e gjuhës gjermane në situata të përditshme, si dhe në fushë profesionale.

Niveli B1

Teston aftësitë për përdorimin e pavarur të gjuhës në situata të zakonshme (punë, shkollë, kohë e lirë, udhëtime, etj.) si dhe monologë me tematika të njohura (mosha: prej 16 vjeç).

Niveli B2

Teston kompetencat gjuhësore në situata të komunikimit, jo vetëm me tematikë të përditshme, por edhe në fushën profesionale dhe në fushën e arsimit (shkollë, studime), si dhe spontanitetin gjatë të folurit dhe përdorimin e shprehive. Në shumë universitete gjermanofolëse ky nivel është një ndër kushtet e pranimit.

Për informata shtesë (mbajtja e provimeve, çmimet etj.) mund të kontaktoni përmes:
+389 72 671200 ose në osdtetovo@gmail.com.

Informata për ÖSD-në dhe shembuj të provimeve mund të gjeni në portalin zyrtar të ÖSD-së: www.osd.at.